



KOMUNA E GJILANIT
OPŠTINA GNJILANE / MUNICIPALITY OF GJILAN / GILAN BELEDIYESI

ZYRA E KRYETARIT
KANCELARIJA PRESEDNIKA / MAYOR'S OFFICE / BASKAN OFISI

Duke u bazuar në nenin 4, 8, 44 dhe 45 të Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme si dhe Ligjin Nr.03/L-205 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-139 për Shpronësimin e Pronës së Paluajtshme, në mbështetje të nenit 11 dhe 13 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, pas shqyrtimit *prima facie* të Kërkesës për Shpronësim Nr.273 të datës 13.02.2023 të Kompanisë Rajonale të Ujësjellësit "Hidromorava" Sh.A Gjilan, Kryetari i Komunës në cilësinë e Organit Shpronësues, miraton këtë :

V E N D I M

1. Aprovohet shqyrtimi i mëtejshëm i kërkesës për shpronësimin për interes publik i të drejtave private pronësore ose të drejtave tjera private në pronë të paluajtshme të pronarëve dhe zotëruesëve të interesit të cilat preken nga realizimi i "Projektit për kanalizimin dhe ndërtimin e kolektorëve" si pjesë e projektit kryesor Fabrika e Ujërave të Zeza (FUTZ) në fshatin Uglar, Komuna e Gjilanit.
2. Shpronësimi të bëhet sipas Elaboratit të Shpronësimit "Projektit për kanalizimin dhe ndërtimin e kolektorëve", sipas tabelave të përshkruara nga evidenca kadastrale për titullarët e pronave të paluajtshme, pozitës së tyre në kuadër të projektit për interes publik dhe sipërfaqeve të tyre të përshkruara në Elaborat për pronat të cilat shtrihen në territorin e Komunës së Gjilanit e i cili do të jetë pjesë përbërëse e këtij vendimi.
3. Vlera e kompensimit të pronave do të caktohet nga Ministria e Financave, konform Ligjit nr.03/L-139 për Shpronësimin e pronës së paluajtshme me Ndryshimet dhe Plotësimet e bëra me Ligjin nr.03/L-205 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2015 "Për zbatimin e metodave dhe kriterëve teknike të vlerësimit që do të përdoren për përllogaritjen e shumës së kompensimit për pronën e paluajtshme që shpronësohet dhe dëmeve që kanë të bëjnë me shpronësimin".
4. Për zbatimin e këtij vendimi obligohen Drejtoria për Gjeodezi, Kadastër dhe Pronë -Sektori për çështje pronësore juridike dhe KRU "Hidromorava" Sh.A Gjilan.
5. Vendimi hyn në fuqi në datën e shpalljes në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës dhe në një gazetë me tirazh më të madh në Kosovë.

Alban HYSENI

Kryetar i Komunës

Iu dërgohet :

- Parashtruesit të kërkesës,
- DGJKP-së,
- Arkivit

Zyra e Kryetarit | Komuna e Gjilanit
Rr. Bulevardi i Pavarësisë PN | Gjilan 60000 | Republika e Kosovës
Tel: +381 280 320 781 | <https://kk.rks-gov.net/gjilan/> | Alban.Hyseni@rks-gov.net